

PROF. SHABAN BAXHAKU*(1931 – 1992)***KRAJA O.**

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Natyrore, Departamenti i Matematikës.

Në jetën relativisht të shkurtër të arsimit të lartë në Shqipëri, figura e doktorit të shkencave matematike, profesorit Shaban Baxhaku pa dyshim është një nga më të spikaturat.

Shabani lindi më 14 janar 1931 në qytetin e Elbasanit. Në Shqipërinë e prapambetjes së thellë arsimore të asaj kohe, Elbasani shquhej si një vatër e rëndësishme patriotizmi, kulture dhe arsimit. Aty lindën shumë figura të shquara të periudhës së Rilindjes sonë Kombëtare dhe të Pavarësisë; aty u themelua e para vatër e përgatitjes së mësuesve për shkollat shqipe, e famshmjia Normale Pedagogjike e Elbasanit, e cila sot mban emrin e themeluesit të saj, Luigj Gurakuqi. Aty lindën e u rritën edhe shumë figura të shquara të shkencës e kulturës sonë bashkëkohore si Aleksandër Xhuvani, Aleks Buda, Kolë Popa, Kolë Papparisto, Mahir Domi etj.



Në familjen e furrarit të mirë të lagjes, dajë Mahmutit, Shabani ishte gëzimi i parë. Pas tij lindën dhe vajza e djem të tjerë që u rritën të mirë e të lumtur. Në çaste përmallimi për fëmijërinë dhe rininë e tij të hershme, Shabanit i pëlqente të kujtonte episode nga puna prej ‘asistenti’ që bënte pranë të atit në furrë.

Gjithmonë nxënës i dalluar, një pjesë të shkollës së mesme Shabani e kreu në Normalen e Elbasanit, ndërsa klasat e fundit i kreu në Pedagogjiken dhe Gjinnazin e Shkodrës, të cilat i përfundoi më 1950. Në ato vite të vështira të pasluftës, në shkollat e mesme të Shkodrës u dërguan si konviktore, me bursë shteti, plot nxënës të mirë nga zonat e tjera të vendit. Shabani që më i miri

ndër më të mirët, prandaj në përfundim të shkollës së mesme u nderua me Medalje.

Në vjeshtë të vitit 1950 Shabani u dërgua për studime të larta në degën e Matematikës të Universitetit të Sofjes; edhe aty Shabani ishte një nga studentët e dalluar. Në përfundim të studimeve të plota universitare, më 1955, ai emërohet pedagog – kështu emërtoheshin atëherë të gjithë, pa dallim – në katedrën e Matematikës dhe Fizikës së Institutit të Lartë Pedagogjik 4-vjeçar të Tiranës, që ishte themeluar katër vjet më parë. Aty ai gjeti kolegët ‘më të vjetër’ Sotir Kuneshkën, Petraq Pilikën, Ligor Gurin, Qazim Turdiun, Petrit Velajn dhe Osman Krajën. Pas një kohe mjaft të shkurtër, në përgjigje të një propozimi të katedrës së Gjeometrisë së Universitetit të Sofjes, Shabani u dërgua atje për të bërë dhe një vit studime, të ngjashme, me atë të çka më vonë u bë dega jonë 5-vjeçare. Aty ai bëri profilizimin shkencor nën drejtimin e Akademikut Petkançin dhe fitoi diplomën universitare e cila në kushtet e sotme do të emërtohej ‘master’ ose ‘magjistër’. Mua më ka rënë rasti të takoj dy herë, më 1965 dhe më 1970, akademikun Petkançin dhe kolegë të tij të Universitetit të Sofjes. Ata e kujtonin Shabanin me shumë konsideratë dhe shprehnin kënaqësi të veçantë që nxënësi i tyre kish filluar të bënte emër si matematikan i shquar i Shqipërisë.

Kthimi i Shabanit në katedër në vitin shkollor 1956-57, në kushtet e një mungese të madhe të kadrove mësimdhënëse, ishte një ngjarje e shënuar. Atij, që në fillim, iu ngarkuan disiplinat gjeometrike, të cilat deri në atë kohë mbuloheshin nga Pepi Pilika dhe unë, me tekste të përkthyer nga rusishtja dhe të përshtatura për programet tona. Më 1955 ishte mbyllur cikli i parë i studimeve 4-vjeçare në degën Matematikë-Fizikë. Paralelisht katedra vazhdonte të mbulonte edhe mësimet në degën dy-vjeçare të Institutit Pedagogjik. Me krijimin e Universitetit Shtetëror të Tiranës, në shtatorin e vitit 1957, katedra Matematikë-Fizikë u nda më dysh – në atë të Matematikës dhe në atë të Fizikës. Tani e tutje katedrat do të mbulonin lëndët përkatëse në të gjithë Universitetin; në këtë mënyrë, që aty u grumbulluan dhe kadro që erdhën nga institutet e tjera të larta të përfshira në Universitet. Në themelimin e saj katedra e Matematikës, e cila për dekada u udhëhoq nga Prof. P. Pilika, kish në përbërje këta pedagogë: Q. Turdiu, K. Fundo, O. Kraja, Sh. Baxhaku, A. Minga, A. Çifligu, Z. Bozgo, K. Bukuroshi dhe docentin e Katedrës së Analizës Matematike të Universitetit Lomonosov të Moskës, doktorin e shkencave matematike Leonid Ivanoviç Kaminjin. Ky i fundit punoi në katedrën tonë si këshilltar e pedagog i Analizës Matematike gjatë viteve 1957-58 dhe 1958-59. Me themelimin e Universitetit edhe dega Matematikë-Fizikë u nda në atë të Matematikës dhe në atë të Fizikës, në të cilat studimet zgjasin 4 vjet.

Krahas zgjerimit të arsimit të lartë u shtruan dhe problemet e kualifikimit shkencor të kuadrit mësimdhënës. Në këtë mënyrë, në vitin 1957-58 u regjistruan në aspiranturë me korrespondencë në Fakultetin Mekaniko-Matematik të Universitetit Lomonosov të Moskës kolegët tanë më të vjetër, Qazim Turdiu dhe Petraç Pilika, kurse në vitin 1958, po në këtë Universitet, u dërgua Shabani për studime të plota aspiranture me shkëputje nga puna. Në historinë e shkencave shqiptare matematike Shabani ishte i pari i kësaj kategorie. Ai u shkoi pranë katedrës së Gjeometrisë Diferenciale të Fakultetit Mekaniko-Matematik. Aty Shabani dha me sukses katër provimet e parashikuara nga programi, ndoqi me kujdes të gjitha seminarët dhe aktivitetet e tjera të kësaj katedre dhe në gusht të vitit 1961 ishte në përfundim të disertacionit me temë *'Mbi disa kongruenca vijëpërkulëta në hapësirën projektive'*. Prishja në këtë kohë e marrëdhënieve me ish BRSS çoi në kthimin në Atdhe të të gjithë shqiptarëve që studionin atje; si shumë të tjerëve, edhe Shabanit i mbeti puna e papërfunduar.

Në Tiranë, krahas punës mësimore me ngarkesë të plotë, Shabani vazhdonte edhe thellimin në problematikën e disertacionit. Në vitin 1964 u vendosën marrëdhënie bashkëpunimi shkencor midis Universitetit të Tiranës dhe Akademisë së Shkencave të R.P. Kinës. Atëherë u vumë në dijeni se në Universitetin e Shangait, Katedra e Gjeometrisë Diferenciale drejtohej nga Su Bu Çin, akademik e matematikan me emër edhe jashtë Kinës; në këtë Katedër punohej në fushën e kongruencave që interesonin Shabanin. Në saje të përkrahjes së fuqishme të Katedrës e të kujdesit të Rektorit të asaj kohe të Universitetit Shtetëror të Tiranës (USHT), Kahreman Yllit, Shabanit iu mundësua në vitin 1965 një stazh 4 mujor pranë Su Bu Çinit në Shanghai, gjatë të cilit ai përfundoi dhe mbrojti me sukses disertacionin me temën që u përmend më sipër dhe fitoi gradën e Kandidatit të Shkencave, gradë e cila më vonë u ekuivalentua në atë të Doktorit të Shkencave. Me këto kualifikime vendi fitoi specialistin e nivelit më të lartë në fushën e gjeometrisë. Ky formim i Shabanit krijoi bazën për përmirësime cilësore në të gjitha disiplinat gjeometrike të degëve të matematikës, duke filluar nga Gjeometria Analitike e Gjeometria Diferenciale dhe duke përfunduar me Bazat e Gjeometrisë.

Pas seminarit shkencor në katedër, që udhëhoqi L. I. Kaminjin në fushën e Analizës Funksionale në vitet 1957–59, seminari në fushën e Gjeometrisë, që organizoi dhe udhëhoqi Shabani që nga viti 1972, që i pari i organizuar 'me forcat tona' dhe më afatgjati (ai zgjati gati 20 vjet). Ky seminar që përbënte një hop të rëndësishëm cilësor në punën e Katedrës së Matematikës dhe një shembull shumë të mirë për të tjerët, shërbeu edhe si bërthama e atij që u quajt Grupi i Gjeometrisë, ku përveç Kristo Fundos u shquan dhe dy Agimat – Karçanaj e Bardulla. Si rezultat i punës shumëvjeçare të këtij seminari u

hartuan dhe u mbrojtën disa disertacione nga fusha e Gjeometrisë. Aty janë diskutuar shumë materiale para se të jepeshin për botim në shtypin shkencor. Këtu lindi edhe nisma për organizimin e Olimpiadave Matematike Kombëtare të niveleve të ndryshme, të cilat për shumë vite janë drejtuar nga anëtarët e grupit të gjeometrisë që udhëhoqej nga Shabani.

Në vlerësim të këtij aktiviteti të shumanshëm, në vitin 1972 Shabani fitoi titullin shkencor Profesor, titull të cilin e mbajti me nder e faqe të bardhë për 20 vjet, deri sa u nda prej nesh, më 4 prill 1992.

Ngritja e nivelit të disiplinave gjeometrike, sidomos pas konsolidimit edhe të degës pesëvjeçare të matematikës në fund të viteve gjashtëdhjetë, nuk kish si të mos gjente jehonën e vet edhe në nivelin e këtyre lëndëve në të gjithë sistemin tonë arsimor, nga fillor deri te më i larti që përfaqësohej nga institutet e larta pedagogjike në fillim në Shkodër e më vonë edhe në Elbasan e Gjirokastër.

Dihet se në periudha të ndryshme në vendin tonë janë zhvilluar diskutime lidhur me sistemin arsimor dhe me përmbajtjen e tij. Qëndrimi i katedrave tona ka qenë gjithmonë për forcimin e formimit matematiko-natyror në të gjitha hallkat e shkollës. Mendimet e Shabanit, që ishte i pranishëm në shumicën e komisioneve ku diskutoheshin këto probleme, kanë qenë gjithmonë racionale dhe me ndikime pozitive. Edhe në periudhën e fundit të viteve të gjashtëdhjetë, kur nën ndikimin e revolucionit kulturor kinez u shkurtuan afatet e studimit në shumë degë të Universitetit, Shabani ishte në krah të atyre që me argumente luftonin për të ruajtur afatet e të dyja degëve të matematikës. Dihet që, me gjithë presionin e madh që i bëhej Fakultetit dhe Katedrës, për shkurtime, u arrit që afatet e studimit në këto dy degë të mos preken.

Në vitin 1970 kur u vendosën marrëdhënie bashkëpunimi midis USHT dhe Universitetit të Prishtinës (UP), Shabani ishte në grupin e parë prej tre pedagogësh të Universitetit tonë që shkoi për të dhënë mësim atje. UP në atë kohë sapo ishte krijuar (si datë e themelimit të UP konsiderohet 15 shkurti 1970) dhe kishte mungesa të mëdha në mësimdhënie dhe në tekste universitare në gjuhën shqipe. Për 7 vjet me radhë në degën e Matematikës së FSHN-së (UP), disiplinat gjeometrike janë mbuluar me leksionet e Shabanit dhe me tekstet e përgatitura prej tij, që përdorëshin si "këndeje" ashtu dhe "andeje". Po ashtu ato tekste janë përdorur edhe në Shkollat e Larta 2-vjeçare të Kosovës që përgatisnin mësues për shkollën 8-vjeçare. Pas Shabanit shkuan për të dhënë mësim në Prishtinë dhe anëtarë të tjerë të Katedrës së Matematikës: P. Pilika, A. Minga, A. Karçanaj etj, të cilët, sikurse Shabani, edhe sot e kësaj dite, pas më shumë se 30 vjetësh, përmenden me respekt nga

brezat e kolegëve të tyre dhe nga qindra matematikanë të Kosovës e viseve të tjera shqiptare të ish Jugosllavisë që kanë kaluar nëpër duart e tyre. Për këtë veprimtari të tij në UP Shabanit në kohë të ndryshme (1980, 2005) i janë dhënë fletë mirënjohjeje nga Rektorati i UP. Me rastin e ndarjes nga jeta të Shabanit, Dekani i Fakultetit të Shkencave Matematiko-Natyrore të UP i ka dërguar dekanit tonë të atëhershëm, Prof. R. Mejdanit, një letër të gjatë ngushëllimi. Edhe me rastin e përkujtimit të Shabanit, në kuadrin e 50-vjetorit të UT, kanë ardhur nga Kosova shumë mesazhe të ngrohta.

Shabani nuk ka qenë vetëm një profesor e shkencëtar i dalluar në katedër e në grupin e gjeometrisë, por Ai duke qenë një atdhetar i flaktë dhe një dashamirës e luftëtar për progresin e vendit, ishte me të vërtetë kudo i pari në punë e sakrificë dhe i fundit në pretendime. Shabani për shumë vite ka qenë zgjedhur në organet drejtuese të Fakultetit. Ai ka qenë pjesëmarrës i dalluar i të gjitha aksioneve ku ka punuar Fakulteti. Në aksionin e parë masiv, në atë të verës 1966 në Jonufër të Vlorës, Shabani ka qenë ndër pedagogët “sulmues” që flinte në fier, njëlloj si studentët. Vështirësitë e panumërta të këtij aksioni Shabani i kalonte me humorin e tij karakteristik por dhe me ndërhyrje në autoritetet vendore e partiake të Vlorës, që mangësitë të ishin sa më të pakta. E njëjta gjë mund të thuhet për aksionin e Malësisë së Madhe të dy viteve më vonë, kur nga pakujdesia e një studenti u dogjën kapanonet. Shabani në krye të situatës dhe gjakftohtë, së bashku me shokët që i donte dhe e donin aq shumë, i riparoi shpejt dëmet dhe situata u normalizua.

Kërkues ndaj vetes dhe ndaj të tjerëve ka qenë komisar Shabani dhe në stërvitjet ushtarake të cilat vazhduan për dekada dhe përgjithësisht zhvilloheshin në kushte mjaft të vështira.

Gjatë periudhës që Shabani punoi në Sektorin e Arsim-Kulturës në Aparatin e atëhershëm të KQ të PPSH, 1977-83, ai nuk i ndërpreu lidhjet me Fakultetin dhe Katedrën, vazhdoi rregullisht mësimet në Tiranë, por jo ato në Prishtinë. Në sektorin që mbulonte në Aparat, me aq sa ia lejonte detyra, luajti rol mjaft pozitiv në riparimin e dëmeve që i u shkaktuan arsimit të lartë dhe kualifikimit shkencor gjatë periudhës së “revolucionarizimit” që u përmend më sipër. Gjatë kohës që Shabani e drejtonte këtë sektor u institucionalizua kualifikimi shkencor i kuadrin universitar dhe akademik, u ristrukturua puna prodhuese e studentëve duke e kthyer atje ku ishte e mundur në praktikë në prodhim ose duke e shkurtuar etj. Mjaft ide racionale të Fakultetit lidhur me domosdoshmërinë e kontakteve të drejtpërdrejta me qendrat e huaja shkencore dhe akademike, lidhur me pjesëmarrjen në aktivitete ndërkombëtare shkencore etj., nëpërmjet Shabanit u formuluan si direktiva partie, dhe sidomos në shkencat natyrore e teknike hapën rrugë të rëndësishme zhvillimi.

Shabani punoi si Dekan i FShN gjatë viteve 1983-88. Ai qe me fat, sepse u caktua drejtues i një Fakulteti të konsoliduar, që kish emrin e fakultetit më serioz të Universitetit, me një kolektiv të ngritur, të kualifikuar, atdhedashës e punëdashës. Por dhe kolektivi qe me fat që i emëruan një dekan si Shabani. Duke e njohur shumë mirë Fakultetin, të gjithë personelin pedagogjiko-shkencor, duke njohur sukseset, por dhe vështirësitë e mangësitë, sidomos në bazë materiale, Shabani - sigurisht me shokë, por duke përdorur dhe emrin e mirë që gëzonte Lart - bëri sa mundi për ta çuar Fakultetin dhe më përpara. Vetëm për ilustrim përmendim vendosjen e kualifikimit shkencor të kuadrin mbi baza më të shëndosha organizative e materiale, edhe me dërgime jashtë shtetit, aq sa ishin mundësitë; modernizimin e Qendrës së Mikroskopisë Elektronike, zgjerimin e Muzeut të Shkencave, kompletimin e Kopshtit Botanik etj.

Virtytet e larta njerëzore, të cilat i kish të trashëguara nga ajo familje e thjeshtë dhe e ndershme, në të cilën lindi e u rrit, aftësia e tij për të marrë nga mjedisi dhe shoqëria atë që është më e mirë, bënë që Shabani gjithë jetën të ishte sinonim i mirësisë, i dashurisë për punën e njerëzit, i përkushtimit ndaj detyrës deri në ekzagjerim e vetëflijim. Unë, ndoshta ndër kolegët tanë, kam qenë më i lumturi e më i privilegjuari, sepse kam pasur fatin të punoj tërë jetën me Shabanin; të punoj e të banoj me të në Moskë dy vjet, të udhëtoj me të në të gjitha qendrat historike të rrethinës së Moskës, të udhëtoj në kohë të ndryshme në Estoni, në Leningrad, Prishtinë, në Francë e gjetkë. Kanë qenë udhëtime të paharruara. Ishte kënaqësi e veçantë të kishe një shok si Shabani në udhëtim.

Shabani kishte hobi fotografinë - ai në Moskë mund të rrinte gjithë natën duke stampuar në dhomën e konviktit, me dritare të errësuar me batanije. Të njëjtën gjë bënte më vonë në Fakultet, në një birucë të përshtatur në ‘laborator fotografik’. I pëlqente shumë shahu - kur niste të luante harronte kohën. Në çdo aktivitet shoqëror ishte i pari dhe më gazmori. Ai bëri gjithmonë jetë shumë të thjeshtë dhe pa pretendime. Ai ishte tepër modest dhe komunikues, sidomos në marrëdhëniet me studentët dhe me kolegët e niveleve më të ulëta se ai. Pati një huq, që nuk e hoqi deri sa vdiq - nuk pati fuqi vullneti të linte duhanin, i cili ia shkurttoi jetën duke i shkaktuar një infarkt të rëndë më 1988 dhe duke i marrë jetën në kulmin e lulëzimit si pedagog e shkencëtar, në moshën 61 vjeçare.

Shabani rriti tre djem të mirë dhe pati fatin që arriti t’i shohë që të tre të shkolluar e në rrugë të mbarë. Sa gëzim do të kish ai t’i shihte sot: Arturin, profesor të matematikës, Fatosin, historian e gazetar me emër, dhe Tanin, mësues të dalluar të italishtes, me nipa e mbesa që ndjekin rrugën e gjyshit të tyre të nderuar.

Në mbyllje të këtyre radhëve po shtroj pyetjen retorike: A bën pjesë Shaban Baxhaku në grupin e figurave të shquara të këtij vendi e të këtij kombi për periudhën kur jetoi e punoi? Ndoshta mund të më quajnë dhe subjektiv, por unë e them me bindje të plotë se Po. A i janë vlerësuar Shabanit kontributet e tij nga instancat përkatëse akademike dhe shtetërore? Mendoj se jo plotësisht. Prandaj u mbetet detyrë kolegëve të tij, ende të gjallë që ta plotësojnë këtë mangësi, sepse e kanë detyrim ndaj Shabanit e ndaj vendit. Në mënyrë më të plotë, me siguri do ta bëjnë këtë brezat e ardhshëm kur do të kërkojnë rrënjët historike të zhvillimit të arsimit të lartë dhe të shkencave matematike në Shqipëri.